



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.1068/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania e Sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria” Sh.A., me seli në Prishtinë, rruga “Pashko Vasa” p.n, kundër debitorit Kompania e Sigurimeve “SIGURIA” Sh.A., me NUI: 810495102, me seli në Prishtinë, rruga “Qamil Hoxha” nr.51, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.623/21 të datës 23.04.2021 të Përmbartuesit Privat Isa Gacaferri me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 17.08.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Kompania e Sigurimeve “SIGURIA”, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.623/21 të datës 23.04.2021 të Përmbartuesit Privat Isa Gacaferri.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.623/21 të datës 23.04.2021 të Përmbartuesit Privat Isa Gacaferri.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Isa Gacaferri, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit në bazë të titullit ekzekutiv – Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë IV.C.nr.467/2010 të datës 28.04.2011, ka nxjerrë urdhrin P.nr.623/21 të datës 23.04.2021, me të cilin ka caktuar zbatimin e përmbartimit ndaj debitorit Kompania e Sigurimeve “SIGURIA” dhe ka detyruar debitorin që të paguaj shumën e përgjithshme prej 15,203.00 €, me kamatë ligjore prej 4.5% në vit, nga data 14.01.2010 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumën prej 634.00 €, të gjitha këto nëpërmjet xhirollogarisë së kreditorit me Nr... në Raiffeisen Bank, ndërsa përmbushja të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit, gjegjësisht sekuestrimin e mjeteve financiare të debitorit në llogarinë rrjedhëse apo në

ndonjë llogari tjetër të debitorit, nëse nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare atëherë të bëhet sekuestrimi i sendeve të luajshme dhe të paluajshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e tij të paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar se urdhri përmbartimor është në kundërshtim me dispozitat e procedurës përmbartimore, pasi që kreditori i ka dorëzuar në fotokopje aktgjykimin me të cilin është lejuar urdhri përmbartimor dhe duke u bazuar në nenin 38 të LPP-së, propozimi për përmbartim duhet përmbaj kërkesën për përmbartim në të cilën tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, e që në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument fotokopje, andaj i ka propozuar Gjykatës që prapësimi i debitori të aprovohet.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ndër të tjera ka deklaruar se sa i përket pretendimeve të debitorit se urdhri për lejimin e ekzekutimit është i pa rregullt sepse ky urdhër i lëshuar nga përmbartuesi privat është i rregullt dhe i përmbartueshëm konform dispozitave të LPP-së. Gjithashtu kreditori ka theksuar se arsyetimet e debitorit janë të pa bazuara në prova dhe fakte dhe kanë të vetmin qëllim shtyrjen e ekzekutimit të aktgjykimin të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj në tërësi prapësimin e debitorit, ta lë në fuqi urdhrin përmbartimor P.nr.623/21 të datës 21.04.2021, si dhe të obligohet debitori t'ia paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përbarimor, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë IV.C.nr.467/2010, të datës 28.04.2011, i formës së prerë nga data 26.06.2013 dhe ekzekutueshëm nga data 08.08.2013, në bazë të së cilit përbaruesi privat ka lejuar përbarimin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenit 23 par.1 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përbarues sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Sipas dokumentit përbarues (titullit ekzekutiv) Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë IV.C.nr.467/2010, të datës 28.04.2011, është detyruar që kreditorëve që në emër të borxhit regresiv t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 15,203.00 €, me kamatë ligjore prej 4.5 % në vit, nga data 14.01.2010 e deri në pagesën definitive.

Gjykata gjeti se dokumenti përbarimor – Aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë IV.C.nr.467/2010, i datës 28.04.2011, është i përbarueshëm ashtu siç përcaktohet në nenin 24 par.1 të LPP-së: *“Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përbarueshëm po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare”*, ngase i njëjti është bërë i formës së prerë nga data 26.06.2013 dhe i ekzekutueshëm nga data 08.08.2013, dhe i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumentit përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që në të janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, objekti, mjetet, si dhe shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë IV.C.nr.467/2010, i datës 28.04.2011, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përbarim, organit përbarues i dorëzohet edhe dokumenti përbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përbarueshmërisë për përbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të këtij neni, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përbarueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë IV.C.nr.467/2010, i datës 28.04.2011, është dorëzuar në origjinal dhe përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbartimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08 L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i Përgjithshëm

KPPP.nr.1068/22 datë 17.08.2023

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.